

DEKLARATË PËR SHTYP

RAPORTI I RI EKSPONON PRURJET E PALIGJSHME FINANCIARE NË BOSNJË DHE HERCEGOVINË, NË MALIN E ZI DHE NË SERBI

Raporti i ri i GI-TOC, Prurjet e paligjshme, financiare në Bosnjë dhe Hercegovinë, në Malin e Zi dhe në Serbi, zbulon nxitësit dhe trendet aktuale të PFP në të tria vendet dhe vëren përpjekjet e qeverisë për të reduktuar krimin.

Vjenë, Austri – 19 Janar 2022: Miliona Euro të prurjeve të paligjshme, financiare (PFP) lëvizin çdo vit përmes Bosnjës e Hercegovinës, Malit të Zi dhe Serbisë, theksohet në një raport të Inicativës Globale Kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar (GI-TOC). Shumica e parave qarkullon përmes sistemeve financiare.

“Bota e krimin po i lëviz paratë e saj përmes botës legale të financave, si brenda rajonit, ashtu edhe nëpërmjet kompanive guaskë (offshore)”, - tha Robin Cartwright, një nga autorët e raportit.

Prurjet e paligjshme, financiare në Bosnjë e Hercegovinë, në Mali të Zi dhe në Serbi: nxitësit dhe trendet, pason një raport në lidhje me PFP-të në Shqipëri, në Kosovë dhe në Maqedoninë e Veriut, që u botua në gusht 2020.

Ky raport sjell informacion të detajuar në lidhje me mekanizmat, me anë të së cilëve paratë e fituara në mënyrë të paligjshme transferohen brenda dhe jashtë tri ekonomive të përfituesve kriminalë në mbarë botën.

Raporti është një analizë e shoqërisë civile, e bazuar në intervista të shumta me zyrtarë kundër pastrimit të parave, oficerë të policisë, këshilltarë të çështjeve të infrastrukturës dhe përfaqësues të shoqërisë civile në të gjithë rajonin. Ndërsa raporti hedh dritë dhe analizon këtë fenomen të rëndësishëm, “mungesa e të dhënave të disponueshme për të gjithë komponentët dhe kanalet e PFP-ve, por veçanërisht për pastrimin e parave dhe kanalet e tregtisë, ka shumë të ngjarë që i bën numrat e paraqitur në raport më të ulët se ç`janë realisht”, - përfundon Cartwright. Raporti gjithashtu vë në dukje se nevojiten më shumë kërkime se si kriptovalutat përdoren për të pastruar paratë.

Raporti shqyrton tre komponentët e PFP-ve, përkatësisht korrupsionin, krimin e organizuar dhe evazionin fiskal. Ai ndjek gjithashtu kanalet, përmes të cilëve lëvizin paratë e pista dhe tregon se institucionet shtetërore të të tria vendeve kanë ndërgjegjësim dhe kapacitet të kufizuar për t'iu përgjigjur në mënyrë adekuate çështjeve që lidhen me prurjet e paligjshme, financiare.

Korrupsioni mbetet një vulnerabilitet kryesor në Ballkanin Perëndimor dhe raporti fokusohet në tri raste studimore: financimi i OJQ-ve në Bosnjë dhe Hercegovinë, industria e mbrojtjes në Mal të Zi

dhe investimet në infrastrukturë në Serbi. “Rasti i Serbisë është veçanërisht interesant, pasi duket se korrupsioni në infrastrukturë ka rritur çmimet me 20-30%, por nuk ka asnjë përgjigje institucionale për ta vërtetuar këtë”, - thotë Sasha Gjorgjeviq, koordinator në terren i GI-TOC për Serbinë dhe Malin e Zi. Ai shton: “por edhe industria e mbrojtjes në Mal të Zi meriton vëmendje të madhe, duke pasur parasysh kontrollet e dobëta të këtij vendi mbi rreziqet e procesit të prokurimit dhe menaxhimin e rrezikut financiar dhe operacional”.

Për sa i përket evazionit fiskal, raporti zbulon se Ballkanit Perëndimor i privohen çdo vit 200 milionë euro nga tregtia e paligjshme e duhanit dhe se tatimi mbi të ardhurat shmanget, duke paguar punëtorët me pará në dorë. Për shembull, në Bosnjë dhe Hercegovinë pothuajse 30% e fuqisë punëtore janë të punësuar joformalisht. Për më tepër, raporti tregon se miliarda euro importe janë vulnerabël kundrejt keq-faturimeve.

Për sa i përket krimit të organizuar, raporti konstaton se trafiku i drogës, tregtia e mallrave të falsifikuara dhe kontrabanda e migrantëve gjenerojnë PFP në shkallë të gjerë. “Tregu për kontrabandën e migrantëve në vitin 2020 vlerësohet të jetë rreth 8,5 deri në 10,5 milionë euro vetëm në Bosnjë dhe Hercegovinë”, - thotë Anesa Agović, koordinatorja në terren e GI-TOC për Bosnjë-Hercegovinën.

Të ardhurat, që fitohen nga korrupsioni, evazoni fiskal, që pastrohen në ekonomitë lokale të Bosnjë-Hercegovinës, Malit të Zi dhe të Serbisë, vlerësohen të jenë ekuivalente me 2-5% të PBB-së vjetore të tyre, në total 1.5 miliardë deri në 3.75 miliardë euro. Pjesa më e madhe e këtyre parave mendohet se qarkullon në sektorin e ndërtimit, pasuri të paluajtshme, turizëm dhe lojëra të fatit.

Raporti del në konkluzionin se, pavarësisht përpjekjeve të rëndësishme të qeverisë për të parandaluar këtë lloj krimi, zbatimi i ligjeve dhe rregulloreve të reja mbetet i kufizuar. “Kjo dekurajon sektorin publik dhe privat të investojë në infrastrukturë thelbësore. Dhe po kështu privon ekonominë e ligjshme nga burimet që nevojiten për zhvillim të qëndrueshëm, si investimet në shëndetësi, shkolla, asistencë sociale dhe siguri publike”, - thotë Kristina Amerhauser, një nga autorët e raportit. Për më tepër, problemi i PFP-ve nuk është kuptuar mirë dhe është ende duke u eksploruar. “Shpresojmë që fokusi i GI-TOC në këtë temë të mund të rrisë ndërgjegjësimin për problemin dhe të sjellë parandalim dhe reagim”, - tha Amerhauser.

For further questions or to interview the report's authors, please contact Claudio Landi (Claudio.landi@globalinitiative.net).

Rreth Inicativës Globale

Iniciativa Globale Kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar është një rrjet profesionistësh që punojnë në vijën e parë të luftës kundër ekonomisë së paligjshme dhe aktorëve kriminalë. Nëpërmjet një rrjeti të vëzhguesve globalë të shoqërisë civile mbi ekonominë e paligjshme, ne monitorojmë tendencat në zhvillim dhe punojmë për të ndërtuar bazën e provave për ndërtimin e politikave, për të shpërndarë ekspertizën e rrjetit tonë dhe për të katalizuar reagime multisektoriale dhe tërësore për një sërë lloje krimesh. Me Fondin e Rezistencës së Inicativës Globale ne mbështesim aktivistët dhe organizatat e shoqërisë civile, që punojnë në zona, ku qeverisja e krimin po minon në mënyrë kritike sigurinë dhe shanset e jetës së njerëzve.